



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0021467-6/26 dt. 29.04.2026
Mitrovicë

02-060/01-0021467-6/26
29.04.2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 77, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.04.2026, pasi shqyrtoi propozim vendimin për vendosjen e Pllakës Përkujtimore për heroin Driton Veliu, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0018345-10/26 dt. 20.04.2026), sjell këtë:

VENDIM

Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Pllakës Përkujtimore për heroin Driton Veliu

1. MIRATOHET Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Pllakës Përkujtimore për Heroin Driton Veliu.
2. Lokacioni për vendosjen e Pllakës Përkujtimore sipas pikës 1 të këtij vendimi gjendet në Parcelën Kadastrale P-71208072-02915-2, në vendin e quajtur “Gradanska ekonomija”, Zona Kadastrale Mitrovicë, pronë e Komunës së Mitrovicës, (Në rrugën që mban emrin Driton Veliu).
3. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së memorialit përkujtimor.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata e pronësisë, incizimi nga Google Earth, dhe ortofoto e lokacionit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës si dhe drejtoritë tjera kompetente.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Sajet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm